



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Nr. 20414/3 Prot.,

Datë 26.02.2026

RREGULLORE TEKNIKE

**“PËR VLERËSIMIN DHE
KLASIFIKIMIN E MJETEVE RRUGORE TË HERSHME ME INTERES
HISTORIK DHE KOLEKSIONIMI”**

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| KREU I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME..... | 4 |
| Neni 1. Hyrje | 4 |
| Neni 2. Qëllimi | 4 |
| Neni 3. Fusha e zbatimit | 4 |
| Neni 4. Baza ligjore..... | 5 |
| Neni 5. Përkufizime | 5 |
| KREU II. KRITERET DHE KLASIFIKIMI | 8 |
| Neni 6. Kriteret e pranimit për fitimin e statusit “RETRO” dhe “Future Classics” | 8 |
| Neni 7. Kriteret e regjistrimit të përkohshëm të mjeteve “Future Classics” | 9 |
| Neni 8. Klasifikimi i mjeteve historike | 10 |
| Neni 9. Lista e Mjeteve Historike | 11 |
| Neni 10. Lista e mjeteve “Future Classics” | 12 |
| KREU III. STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE TRANSPARENCA..... | 13 |
| Neni 11. Strukturat e trajtimit të aplikimeve | 13 |
| Neni 12. Komisioni "RETRO" dhe përbërja e tij..... | 15 |
| Neni 13. Përzgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit "RETRO" | 15 |
| Neni 14. Publikimet zyrtare dhe format e aplikimit | 16 |
| KREU IV. APLIKIMI, VERIFIKIMI DHE DOKUMENTACIONI..... | 17 |
| Neni 15. Aplikimi dhe dokumentacioni bazë | 17 |
| Neni 16. Verifikimi i mjetit nga Komisioni "RETRO" | 18 |
| Neni 17. Administrimi i dokumentacionit | 27 |
| Neni 18. Mospërputhja e të dhënave të pronësisë | 28 |
| Neni 19. Mjetet në zotërim të institucioneve publike apo që administrohen nga Shteti | 29 |
| KREU V. CERTIFIKIMI, REGJISTRIMI DHE QARKULLIMI..... | 30 |
| Neni 20. Formularët “R” | 30 |
| Neni 21. Certifikata e Njohjes | 31 |
| Neni 22. Regjistri “RETRO” | 31 |
| Neni 23. Targa “RETRO”..... | 33 |



| | |
|---|-----------|
| Neni 24. Autorizimi për lëvizje | 34 |
| Neni 25. Shërbimi në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor..... | 34 |
| Neni 26. Shërbime dhe tarifa | 35 |
| KREU VI. DISPOZITA TË FUNDIT | 36 |
| Neni 27. Të drejtat që burojnë nga zotërimi i një mjeti “RETRO” | 36 |
| Neni 28. Detyrimet që sjell zotërimi i një mjet “RETRO” | 36 |
| Neni 29. Promovimi i trashëgimisë automobilistike..... | 37 |
| Neni 30. Detyrime të përgjithshme | 37 |



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Hyrje

Kjo Rregullore miratohet në mbështetje të nenit 60, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 211/a, të Vendimit Nr. 153, datë 07.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe është akt normativ i detyrueshëm për të gjitha strukturat e DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-ve, të cilat ushtrojnë kompetenca në administrimin e mjeteve rrugore të hershme me interes historik dhe koleksionimi.

Neni 2

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë kuadrin e nevojshëm normativ dhe të vendosë rregulla të hollësishme për:

- Përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe klasifikimit të ciklomotorëve, motomjeteve dhe automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi për njohjen e statusit “*RETRO*”;
- Rregullat për trajtimin e kërkesave për njohjen e statusit “*RETRO*” dhe regjistrimin e këtyre mjeteve;
- Promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë automobilistike kombëtare.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për mjetet rrugore me interes historik dhe koleksionimi që vlerësohen për fitimin e statusit “*RETRO*”, për mjetet që e kanë fituar këtë status, si dhe për mjetet e identifikuar si “*Future Classics*” sipas listave referuese të miratuara nga DPSHTRR, pavarësisht nëse janë në qarkullim, të importuara apo të ruajtura për koleksion.

Dispozitat e saj zbatohen për zotëruesit/pronarët e këtyre mjeteve, si dhe për strukturat e DPSHTRR-së që marrin pjesë në vlerësimin, evidentimin dhe regjistrimin e tyre, përfshirë Sektorin *RETRO*, Komisionin *RETRO* dhe DRSHTRR-të. Mjetet *RETRO* trajtohen si mjete me përdorim të veçantë, për qarkullim të kufizuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore.



Neni 4 Baza ligjore

Baza ligjore në të cilën mbështetet kjo Rregullore është si më poshtë:

- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.
- VKM-ja nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.
- VKM-ja nr. 633, datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, të ndryshuar.
- VKM-ja nr. 153, datë 3.4.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”.
- Udhëzimi i MIE nr. 4, datë 28.06.2019, “Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 28, datë 10.07.2023, "Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet rrugore", miratuar me shkresën nr. 5935/1 Prot, datë 10.07.2023, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ndryshuar me Vendimin nr. 25, datë 09.10.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKD nr. 28, datë 10.07.2023, "Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet rrugore", miratuar me shkresën nr. 7982/1 Prot, datë 06.12.2024, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 5 Përkufizime

Në kuptim të kuadrit ligjor dhe në zbatim të kësaj Rregulloreje, përkufizimet e mëposhtme janë:

- *Mjet rrugor i hershëm* – mjet rrugor i vjetër me interes historik/koleksionimi, i kërkuar nga zotëruesi i mjetit për vlerësim, por që nuk e ka fituar ende statusin “RETRO”.
- *Mjet RETRO* – mjet rrugor i hershëm, me vjetërsi së paku 30 vjeçare, me interes historik dhe koleksionimi, i cili nuk është në prodhim dhe që ka fituar statusin “RETRO” pas vlerësimit dhe klasifikimit nga një komision i posaçëm, mbi bazën e shqyrtimit të



dokumentacionit dhe verifikimit teknik si dhe është pajisur me Certifikatën e Njohjes dhe targë *RETRO*.

- *Mjet "Future Classics"* – mjet rrugor me moshë nën 30 vjet, që vlerësohet se ka potencial të lartë për t'u bërë mjet *RETRO* në të ardhmen, për shkak të rrallësisë, rëndësisë teknike dhe kulturore, versionit të veçantë dhe/ose ruajtjes së origjinalitetit të tij.
- *Regjistër RETRO* – regjistër në të cilin regjistrohen të dhënat e mjeteve rrugore të hershme, pasi kanë fituar statusin "*RETRO*".
- *Spektori RETRO* – struktura organizative në DPSHTRR, që administron dokumentacionin dhe koordinon veprimet me aplikantët.
- SHVS – Sektori i Homologimit dhe Verifikimit të Specializuar, strukturë organizative në DPSHTRR për trajtimin e aplikimeve për importin e mjeteve rrugore të hershme.
- *Lista e mjeteve Future Classics* – është lista referuese e miratuar nga DPSHTRR, e markave, modeleve dhe versioneve sipas vitit të prodhimit të mjeteve me interes historik që mund të kategorizohen si future classics.
- *Lista e mjeteve historike* – është lista referuese e miratuar nga DPSHTRR, e markave, modeleve dhe versioneve sipas vitit të prodhimit, të mjeteve kandidate për "*RETRO* të prodhuara pas datës 31.12.1970.
- *Targë RETRO* – është targa e cila plotëson të gjitha standardet teknike, të parashikuara në shkronjat j) dhe k), të nenit 248 të VKM-së nr. 153, datë 07.04.2000 "*Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar, dhe që përdoret për regjistrimin e mjeteve *RETRO*.
- *Autorizim për lëvizje* – është dokumenti (akti administrativ) me të cilin pajiset zotëruesi i mjetit *RETRO*, me afat për lëvizje deri në 30 ditë, sipas shtojcës II.
- *Komision RETRO* – Komisioni i përbërë nga 1 kryetar dhe 4 anëtarë, i ngarkuar të kryejë verifikimin e dokumentacionit, verifikimin teknik dhe vlerësimin e mjeteve rrugore të hershme.
- *Certifikatë Njohje* – dokument zyrtar lëshuar nga DPSHTRR që vërteton statusin "*RETRO*" të mjetit, sipas shtojcës I.
- Formulari R01 – dokument vetëdeklarimi nga zotëruesi i mjetit rrugor të hershëm në mungesë të dokumentacionit të origjinës, mbi shqyrtimin e kërkesës për fitimin e statusit "*RETRO*", sipas shtojcës III.
- Formulari R02 – dokument që plotësohet nga Komisioni "*RETRO*" për vlerësimin e përmbushjes së kritereve të një mjeti rrugor të hershëm, me qëllim dhënien ose jo të statusit "*RETRO*", sipas shtojcës V.



- Formulari R03 – akt konstatim i hartuar nga kryetari i komisionit “*RETRO*”, mbi përmbushjen e kriterëve dhe miratimin e statusit “*RETRO*” të një mjeti rrugor të hershëm, sipas shtojcës IV.
- *Vit prodhimi* – viti kalendarik në të cilin mjeti konkret ka përfunduar procesin e fabrikimit (data e përfundimit të prodhimit/ndërtimit) në linjën e prodhuesit ose viti i shënuar në dokumentacionin shoqërues si “*model year*” (viti i modelit), veçanërisht kur mjeti është prodhuar në fund të vitit kalendarik dhe prodhuesi e evidenton modelin si pjesë të vitit pasardhës.
- *Marka* – është emri që identifikon prodhuesin e mjetit.
- *Prodhues* – personi fizik/juridik që ka ndërtuar/prodhuar mjetin.
- *Model/Tip/Seri* – emërtimet e prodhuesit, të përcaktuara edhe për nevoja të tregtimit, që shërbejnë për të dalluar mjetin nga mjetet e tjera të së njëjtës markë dhe për të përcaktuar linjën/variantin brenda gamës së prodhimeve të asaj marke.
- *Replika* – mjet i riprodhuar nga prodhuesi origjinal ose i ndërtuar/realizuar nga një subjekt i tretë, me porosi ose me autorizim të prodhuesit origjinal (në emër dhe për llogari të tij).
- *Ndryshim konstruktiv* – ndërhyrje të kryera në mjet, pas prodhimit, që ndryshojnë ose zëvendësojnë elemente të tij dhe sjellin ndryshim të karakteristikave origjinale (konstruktive, funksionale ose pamore), në mënyrë të përhershme ose të rikthyeshme, përfshirë ndryshime në agregate, shasi/trup, sistem drejtimi, frenimi, motor/transmision, apo konfigurimin e pajisjeve.
- Sistemi i frenimit konvencional – është sistemi hidraulik i frenimit, i përbërë nga mekanizma frenues me disqe dhe/ose tamburë në të gjitha rrotat e mjetit rrugor.
- *Shfrytëzim ekonomik* – përdorimi i mjetit kundrejt pagesës ose kompensimit, i lejuar vetëm kur lidhet drejtpërdrejt me prezantimin, promovimin ose ruajtjen e vlerave historike/kulturore që përfaqëson mjeti *RETRO* (p.sh. pjesëmarrje në evente, ekspozime, xhirime filmash/fotografime), dhe jo për qëllime utilitare të zakonshme, si transport mallrash, shërbime transporti, logjistikë ose aktivitete të tjera që nuk lidhen me destinacionin kulturor/koleksionues të mjetit.
- *FIVA* – Fédération Internationale des Véhicules Anciens (Federata Ndërkombëtare e Mjeteve Historike).
- *CRM* – Customer Relationship Management, është platformë e miratuar për trajtimin digjital të aplikimeve.



KREU II **KRITERET DHE KLASIFIKIMI**

Neni 6

Kriteret e pranimit për fitimin e statusit “RETRO” dhe “Future Classics”

Mjetet rrugore të hershme të cilat kanë për qëllim të regjistrohen si mjete “RETRO” duhet t’i përmbahen kriterëve të mëposhtme:

1. Statusi “RETRO” i jepet një mjeti rrugor të hershëm vetëm kur, pas vlerësimit nga Komisioni “RETRO”, ai plotëson kriteret e përgjithshme si më poshtë:
 - a. mjeti të jetë prodhuar së paku përpara 30 (tridhjetë) vjetësh;
 - b. të jetë i ruajtur, i restauruar apo i rikonstruktuar në formën e tij origjinale;
 - c. të mos përdoret për qarkullim të përditshëm dhe të mos ketë shfrytëzim ekonomik;
 - d. të klasifikohet në kategorinë e mjeteve rrugore me vlerë historike;
 - e. të mos jetë më në prodhim.
2. Mjetet që janë ose kanë qenë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, të cilat zbatohen pavarësisht statusit të mjetit në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve Rrugore.
3. Për mjetet që importohen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë, përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, zbatohen edhe rregullat e mëposhtme:
 - a. importi i një mjeti rrugor të hershëm, të prodhuar pas datës 31.12.1970, kufizohet sipas Listës së Miratuar të Mjeteve Historike dhe Listës “Future Classics”, në përputhje me parashikimet e nenit 9 dhe 10 të kësaj Rregulloreje;
 - b. përjashtimisht nga shkronja “a”, mund të shqyrtohen për fitimin e statusit “RETRO” edhe automjetet e hershme rrugore të importuara që zotërojnë një Certifikatë Historike të vlefshme, të lëshuar nga një klub i huaj me anëtarësim në FIVA.
4. Mjetet Replika (*Replica*) mund të importohen dhe të pranohen për verifikim, nëse plotësojnë kriteret e përgjithshme sipas pikës 1, si dhe nëse imitojnë modele të prodhuara para datës 31.12.1970. Modelet e imituara që i përkasin periudhës pas datës 31.12.1970 pranohen vetëm nëse përfshihen në listën e mjeteve historike. Për qëllim të përcaktimit të kriterit të vjetërsisë, merret si referencë viti i montimit/ndërtimit efektiv i mjetit dhe jo viti i prodhimit të modelit të imituar.
5. Për mjetet “Future Classics”, zbatohet rregulli i vjetërsisë më të vogël se 30 vjeçare si dhe modeli/varianti i tyre duhet të jetë pjesë e listës së mjeteve “Future Classics”. Mjetet “Future Classics” nuk mund të pajisen me Certifikatë Njohjeje, por mund të regjistrohen përkohësisht, pas vlerësimit nga Komisioni Retro, vetëm gjatë periudhës së fundit 5 (pesë)



vjeçare, përpara se të përmbushin kriterin e vjetërsisë 30 (tridhjetë) vjet për marrjen e statusit Retro.

Sistemi i drejtimit në krahun e djathtë lejohet për mjetet të cilat i plotësojnë kriteret për marrjen e statusit "RETRO", vetëm në rastet kur mjeti është i prodhuar nga prodhuesi me këtë lloj sistemi drejtimi.

Neni 7

Kriteret e regjistrimit të përkohshëm të mjeteve "Future Classics"

1. Mjetet rrugore të hershme me interes historik dhe koleksionimi, të cilat synojnë të regjistrohen si mjete "RETRO", por që aktualisht nuk e plotësojnë kriterin e vjetërsisë 30 vjet, kanë të drejtën të aplikojnë për një skemë regjistrimi të përkohshme. Qëllimi i regjistrimit të përkohshëm është ruajtja e vlerave teknike dhe autentike të mjetit rrugor të hershëm, në mënyrë që ai të mos dëmtohet nga mospërdorimi, duke mos humbur kështu mundësinë për t'u kualifikuar si mjet "RETRO" pasi të arrijë vjetërsinë e kërkuar. Mjetet e përfshira në listën "Future Classics", me vjetërsi nga 25 vite deri në përmbushjen e vjetërsisë së nevojshme prej 30 (tridhjetë) vitesh, mund të pajisen me leje qarkullimi për qarkullim të përditshëm dhe targa të zakonshme, duke u regjistruar përkohësisht në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve Rrugore. Leja e qarkullimit e këtyre mjeteve duhet të lëshohet me afat të përcaktuar, sipas afatit të konfirmuar nga Komisioni "RETRO" deri në përmbushjen e vjetërsisë së nevojshme prej 30 (tridhjetë) vitesh. Regjistrimi i përkohshëm jepet për një afat të përcaktuar, jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Pas këtij afati, mjeti duhet detyrimisht të çregjistrohet si mjet për qarkullim të përditshëm dhe do t'i nënshtrohet rregullave për fitimin e statusit "RETRO" dhe regjistrimin si mjet "RETRO".
2. Kriteret për regjistrimin me afat të caktuar të këtyre mjeteve janë si më poshtë:
 - a. Të jenë të prodhuara ndërmjet 25 dhe 29 vite;
 - b. Përpara regjistrimit të mjetit, të jetë vlerësuar nga Komisioni "RETRO" që kriteret për fitimin e statusit "RETRO" sipas nenit 6, por me përjashtim të germës "a" të pikës 1 të nenit 6, janë përmbushur;
 - c. Të jenë lëshuar Formularët R01, R02, R03;
 - d. Nga ana e komisionit "RETRO", në formularin R03, duhet të jetë përcaktuar:
 - afati se kur do të përfundojë regjistrimi si mjet për përdorim të përditshëm (afat i cili do të shënohet në rubrikën "shënime" në lejen e qarkullimit) dhe nuk mund të bëhet ndërrimi i pronësisë deri në momentin e fitimit të statusit "RETRO";
 - vendimi që mjeti i plotëson kriteret dhe ndjekja e procedurave për regjistrim për përdorim të përditshëm deri në përfundim të afatit.
3. Sektori "RETRO", administron dosjen e inventarizuar me dokumentacionin objekt verifikimi dhe e dërgon zyrtarisht në DRSHTRR përkatëse.



4. Rregullat që duhet të zbatohen nga punonjësit e DRSHTRR-ve:
 - a) Specialisti i identifikimit në DRSHTRR, verifikon treguesit e mjetit sipas formularit R02 dhe këqyrjes fizike të mjetit duke plotësuar dokumentin e identifikimit të treguesve teknik të mjetit;
 - b) Për regjistrimin e këtyre mjeteve në DRSHTRR-të respektive, do të zbatohet procedura në fuqi e regjistrimit të mjeteve rrugore;
 - c) Nga DRSHTRR-ja ku mjete ka përfituar shërbimin, do të aplikohet masa administrative e bllokimit të pronarit në sistem, duke pezulluar çdo procedurë për ndryshimin e pronësisë së mjetit deri në përmbushjen e kriterit ligjor të vjetërsisë prej 30 (tridhjetë) vjetësh.
 - d) Pronari i mjetit do të njoftohet paraprakisht për datën e përfundimit të afatit të përcaktuar, pas përfundimit të afatit të përcaktuar në lejen e qarkullimit, pronari duhet të dorëzojë targat dhe lejen e qarkullimit. Nëse pronari nuk paraqitet brenda afatit 30 ditor, DRSHTRR kryen njoftimet me shkresë zyrtare drejtuar zotëruesit të mjetit dhe pas 7 (ditësh) kalendarike, bën bllokimin total të mjetit dhe kryen njoftimin pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit.
 - e) Me përmbushjen e kriterit të vjetërsisë 30 vite, me kërkesën e zotëruesit mjetei çregjistrohet nga regjistri kombëtar i mjeteve rrugore (Çregjistrim i përhershëm për Retro) duke ndjekur procedurën e çregjistrimit për mjetet, me status "*RETRO*" ku dorëzon lejen e qarkullimit, targat e mjetit dhe i nënshtrohet sërish verifikimit nga Komisioni "*RETRO*", me qëllim pajisjen përfundimtare me statusin e mjetit historik.

Neni 8

Klasifikimi i mjeteve historike

Klasifikimi i mjeteve "*RETRO*" kryhet në zbatim të Shtojcës XII të Vendimit nr. 153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, sipas kategorive:

1. Kategoria e vjetërsisë:

- A – E para – Nga mjete i parë i prodhuar deri më 31.12.1904;
- B – Veteran – 1.1.1905 deri më 31.12.1918;
- C – Antike – 1.1.1919 deri më 31.12.1930;
- D – Post Antike – 1.1.1931 deri më 31.12.1945;
- E – Post 1945 – 1.1.1946 deri më 31.12.1960;
- F – Post 1960 – 1.1.1961 deri më 31.12.1970;
- G – Post 1970 – 1.1.1971 deri më 30 vjet vjetërsi.

2. Kategoria teknike:

- A) Standard – tregon që një mjet rrugor i hershëm është prodhuar në versionin bazë (standard) pa shtesa dhe ndryshime në performancë dhe konstruksionin e kabinës apo karrocërisë.



- B) Modifikim – tregon që një mjet rrugor i hershëm është prodhim i një serie të veçantë e një modeli me modifikime apo përmirësime konstruktive të cilat kanë një performancë të rritur në krahasim me versionin bazë nga prodhuesi.
- C) Kopje – tregon që një mjet rrugor i hershëm është riprodhuar nga vetë prodhuesi apo përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Kjo klasë tregon mjetet që njihen ndryshe si “*Replica*”.
- X) E pranueshme – tregon që një mjet rrugor i hershëm është riprodhuar me të njëjtat specifikime nga një entitet i cili nuk është prodhuesi origjinal apo përfaqësuesi i autorizuar prej tij.

3. Kategoria e ruajtjes së formës:

- 1) Original – tregon që për një mjet rrugor të hershëm është ruajtur forma e tij origjinale e fabrikimit dhe mbi të nuk është kryer asnjë ndërhyrje mekanike.
- 2) Burimor (autentik) - tregon që për një mjet rrugor të hershëm është ruajtur forma e tij origjinale duke përdorur pjesë apo komponent origjinal/autentik, që i përkasin ekzaktësisht atij modeli mjeti.
- 3) Rinovuar – tregon që për një mjet rrugor të hershëm është ruajtur forma e tij, por mbi të janë kryer restaurime sipërfaqësore të elementëve me komponente që i përkasin periudhës kur mjeti është prodhuar.
- 4) Rikonstruktuar – tregon që për një mjet rrugor të hershëm është ruajtur forma e tij, por mbi të janë kryer riparime thelbësore që prekin strukturën primare dhe sekondare të mjetit, me elementë që i përkasin këtij modeli të asaj periudhe.

Pas verifikimit të mjetit, Komisioni "*RETRO*" përzgjedh kodin përkatës të kategorisë për mjetin që fiton statusin "*RETRO*", sipas tabelave përkatëse të përcaktuara në pikën 14, 15 dhe 16 të Formularit R02, në Shtojcën V.

Neni 9

Lista e Mjeteve Historike

Lista e mjeteve historike, është lista e hartuar dhe miratuar nga DPSHTRR, me markat, modelet dhe versionet e mjeteve rrugore të hershme, që konsiderohen se mbartin vlera historike, kandidatë për të fituar statusin "*RETRO*", të prodhuara pas datës 31.12.1970. Kjo listë ka për qëllim rritjen e cilësisë së automjeteve të hershme që importohen në Republikën e Shqipërisë. Lista e Mjeteve Historike propozohet nga Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Sektori "*RETRO*" dhe Sektori "*SHVS*", mbështeten në këtë listë për trajtimin e aplikimeve për mjetet "*RETRO*".

Lista përditësohet në mënyrë periodike çdo 1 muaj dhe publikohet në faqen zyrtare www.retro.al.

Përditësimi do të bazohet në:

- a. Kërkesat nga aplikimet e ardhura nga faqja zyrtare web në fushën "*sugjero mjet historik*".
- b. Në manualët teknike apo revista të dedikuara për mjetet historike dhe historinë e automobilizmit, nga hulumtimet e Sektorit "*RETRO*" për zhvillimin e këtij Sektori.



Kriteret për përzgjedhjen e modeleve që do të propozohen për t'u shtuar në listë, janë:

- a. Mbartja e vlerave historike për një model të caktuar;
- b. Origjina e mjetit (p.sh. mjete të prodhuara në vendet e ish Bashkimit Sovjetik, Kinë, apo vende të tjera të bllokut lindor, etj);
- c. Përdorimi i mjetit në një eveniment/aktivitet që shënon një ngjarje të rëndësishme në histori;
- d. Që paraqesin vlera teknike të rralla muzeale apo kulturore, trashëgimi tradicionale dhe sociale;
- e. Automjetet e prezantuara si model i prodhimit deri në 31 dhjetor 1970, por të prodhuara pas kësaj date.

Spektori i Mjeteve Historike (RETRO), brenda 5 ditëve të fundit të muajit përgatit relacionin me propozimet për përditësimin e listës së "mjeteve historike", i cili i dërgohet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 10

Lista e mjeteve "Future Classics"

Lista e mjeteve "Future Classics", është lista e miratuar nga DPSHTRR, me markat, modelet dhe versionet e mjeteve rrugore të hershme, që konsiderohen se mbartin vlera historike, në pritje për të fituar statusin "RETRO", të cilat ende nuk e kanë arritur vjetërsinë e kërkuar 30 vjet.

Lista e mjeteve "Future Classics" propozohet nga Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Spektori "RETRO" dhe Spektori "SHVS", mbështeten në këtë listë për trajtimin e aplikimeve për mjetet "RETRO".

Kriteret dhe përditësimi i kësaj liste kryhet njësoj siç parashikohet në nenin 9, të kësaj Rregulloreje.

Spektori i Mjeteve Historike (RETRO), brenda 5 ditëve të fundit të muajit përgatit relacionin me propozimet për përditësimin e listës "Future Classics", i cili i dërgohet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm.



KREU III

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE TRANSPARENCA

Neni 11

Strukturat e trajtimit të aplikimeve

1. Sektori “SHVS”:

SHVS bën shqyrtimin e kërkesave/aplikimeve për importin e mjeteve mbi bazën e listave të miratuara të mjeteve “RETRO” dhe “Future Classics”.

Detyrat e specialistëve të sektorit “SHVS” të Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve në DPSHTRR, për trajtimin e këtyre aplikimeve, janë si më poshtë:

- Shqyrton dhe verifikon të dhënat e deklaruara nga aplikuesi në platformën CRM, sipas kritereve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 6;
- Verifikon modelin/variantin e mjetit bazuar në dokumentacionin e origjinës, numrin e identifikimit dhe platformat/manualet teknike, duke u bazuar në Listën e miratuar të mjeteve historike dhe “Future Classics”.
- Dërgon përgjigjen përfundimtare në adresën elektronike të deklaruar nga aplikanti dhe për dijeni në adresën elektronike zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Në rast se mjeti refuzohet, për shkak se nuk është pjesë e listës së mjeteve historike ose “Future Classics”, përgjigja duhet të përmbajë edhe informacionin se këto lista janë subjekt i përditësimit periodik, si edhe udhëzimin se procedura për përfshirjen e modelit të kërkuar në këto lista mund të kryhet nëpërmjet aplikimit elektronik, në formën e gatshme, në faqen zyrtare të internetit përmes lidhjes: [SUGJERO MJET HISTORIK | Retro - Koleksioni Shqiptar](#)

2. Sektori “RETRO”:

Sektori “RETRO”, në Drejtorinë e Regjistrimit të Mjeteve, bën shqyrtimin e kërkesave/aplikimeve për fitimin e statusit “RETRO”.

- a. Detyrat e sektorit “RETRO”, lidhur me trajtimin e aplikimeve për fitimin e statusit “RETRO”, janë si më poshtë:
 - Shqyrton dhe verifikon në platformën CRM, të dhënat e deklaruara nga aplikuesi, sipas përcaktimeve të nenit 6;
 - Mban komunikimin me aplikuesin, duke respektuar afatet e parashikuara në këtë Rregullore dhe jep përgjigje të argumentuara.
 - Specialisti i sektorit “RETRO” jep aprovimin për vijimin e procedurës së verifikimit brenda 3 (tre) ditësh pune.



- Në rast se gjykohet që mjeti nuk i plotëson kushtet për të fituar statusin "RETRO", specialisti i sektorit "RETRO" kthen një përgjigje të argumentuar për refuzimin.
- b. Detyrat e Sektorit "RETRO", lidhur me Komisionin, janë si më poshtë:
- Përgatit dosjen e mjetit, për të cilin Komisioni "RETRO" do të kryejë verifikimin fizik. Dosja për qëllim të verifikimit në Komision duhet të përmbajë:
 - E-mail-i i aplikimit;
 - Deklarimet sipas e-mailit;
 - Formulari R01 (për t'u plotësuar nga zotëruesi i mjetit);
 - Formulari R02 (për t'u plotësuar nga komisioni);
 - Formulari R03 (për t'u plotësuar nga kryetari i komisionit).
 - Për mjetet e regjistruara më parë, verifikon të dhënat në sistemin *eDPSHTRR*, mbi statusin e mjetit;
 - Cakton datën, orën dhe vendin e mbledhjes së Komisionit "RETRO", si dhe njofton aplikantin dhe anëtarët e Komisionit;
 - Verifikon kryerjen e pagesës për vlerësimin nga Komisioni "RETRO" sipas tarifave të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin rrugor. Gjithashtu edhe në rastet e rivlerësimit.
 - Në përfundim të verifikimit dhe vlerësimit nga komisioni, administron dokumentacionin përkatës.
 - Pas kryerjes së pagesës për procedurën e klasifikimit nga ana e Komisionit *RETRO* si mjet rrugor i hershëm, certifikatës së njohjes, librit të lëvizjes (autorizimit) dhe pajisjes me targë *RETRO* të mjeteve rrugore, vijon me printimin e certifikatës së njohjes, autorizimit dhe porosinë e targave.
 - Hedh të dhënat në Regjistrin *RETRO*.
 - Dërgon certifikatën e njohjes, librin e udhëtimit dhe targën e mjetit në *DRSHTRR*, ku ka në juridiksion vendbanimin e zotëruesit.
 - Dërgon dosjen e mjetit të inventarizuar me shkresë përcjellëse, në Sektorin e Arkivit të Dokumentacionit të Mbyllur, në *DPSHTRR*.
- c. Raportimi nga Sektori "RETRO":
- Përgatit një relacion përfundimtar mujor mbi komisionet e zhvilluara gjatë muajit ku evidentohen të dhënat e mjeteve rrugore të hershme me zotëruesit e tyre të paraqitura në Komision sipas datave të paraqitjes dhe rezultatet (fitues/jo-fitues), vendin ku janë zhvilluar komisionet, informacion mbi anëtarët e komisionit të cilët kanë kryer vlerësimet.
 - Relacioni konfirmohet nga Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
 - Pas miratimit të relacionit, Sektori "RETRO" vijon me shkresën "*Kërkesë për pagesën e anëtarëve të komisionit RETRO, përfaqësues të komunitetit RETRO dhe për anëtarin e komisionit përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për transportin*", sipas pagesës së përcaktuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje.
 - Me vënien në dispozicion të dokumentave të sipërcituara, Drejtoria Ekonomike do të vijojë me kryerjen e pagesës.



Neni 12

Komisioni "RETRO" dhe përbërja e tij

Komisioni "RETRO" ka si funksion kryesor përcaktimin e statusit "RETRO" të mjeteve rrugore të hershme si dhe klasifikimin e tyre, nëpërmjet verifikimit në vend të tyre dhe vlerësimit sipas formularit R02. Ky Komision ka në përbërje:

- Dy përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Një përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për transportin rrugor;
- Dy përfaqësues nga radhët e Komunitetit "RETRO".

Për punën e kryer, anëtarët e Komisionit "RETRO", që nuk vijnë nga radhët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, do të trajtohen me një pagesë të veçantë. Pagesa e tyre do të jetë e barabartë me pagën ditore të Përgjegjësit të Sektorit të Regjistrimit të Mjeteve.

Çdo anëtar plotëson paraprakisht një deklaratë mbi konfliktin e interesit dhe përjashtohet nga vlerësimi i mjeteve që lidhen me vetë anëtarin, familjarët e tij apo subjektet me të cilat ka marrëdhënie ekonomike.

Neni 13

Përzgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit "RETRO"

1. Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit "RETRO":

- Anëtarët e komisionit "RETRO" të cilët janë përfaqësues të DPSHTRR-së, caktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.
- Anëtari i komisionit 'RETRO', i cili është përfaqësues i Ministrisë përgjegjëse për transportin, caktohet nga Ministria përgjegjëse për transportin dhe emërohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së.
- Anëtarët e komisionit "RETRO" nga radhët e komunitetit të koleksionistëve, përzgjidhen për një periudhë 1-vjeçare. Përzgjedhja bëhet pasi të jenë zbatuar procedurat e nevojshme të aplikimit sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe duke u mbështetur në:
 - Aftësitë profesionale;
 - Përvojën;
 - Kualifikimet dhe njohuritë e tyre teknike.

Në rast se ka më shumë se dy aplikime, atëherë do të përzgjidhet kandidati që ka më shumë kualifikime apo dëshmon se është njohës më i mirë i mjeteve historike.

2. Përzgjedhja e kryetarit të komisionit "RETRO":



Kryetari i komisionit "RETRO" propozohet nga anëtarët e komisionit me shumicë të thjeshtë, me kushtin që ai të jetë nga radhët e DPSHTRR-së apo ministrisë përgjegjëse për transportin, i cili më pas miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 14

Publikimet zyrtare dhe format e aplikimit

1. Çdo njoftim zyrtar, informacion mbi aktivitetet e organizuara në kuadër të "RETRO" si dhe çdo dokument i publikuar në zbatim të kësaj Rregulloreje, bëhet përmes faqeve zyrtare www.retro.al dhe www.dpshttrr.al, si dhe rrjeteve sociale zyrtare të DPSHTRR-së.
2. Aplikimet në kuadër të kësaj Rregulloreje kryhen nëpërmjet formave të faqes zyrtare web në www.retro.al dhe www.dpshttrr.al dhe ndiqen nëpërmjet platformës CRM të DPSHTRR-së, si më poshtë:
 - a. Formë aplikimi me të dhënat e mjetit dhe të zotëruesit të tij, për mjetet e importuara, për verifikimin dhe zbatimin e kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.
 - b. Formë aplikimi mbi kërkesën për fitimin e statusit "RETRO", për shqyrtim dhe vendimmarrje nga Komisioni "RETRO".



KREU IV
APLIKIMI, VERIFIKIMI DHE DOKUMENTACIONI

Neni 15

Aplikimi dhe dokumentacioni bazë

1. Aplikimi për importin e mjeteve rrugore të hershme:

Çdo individ/subjekt që synon të importojë një mjet rrugor të hershëm, me qëllim regjistrimin si mjet "RETRO", duhet të marrë një aprovim paraprak nga DPSHTRR për lejimin e importit të mjetit në fjalë.

Aplikimet për importimin e mjeteve rrugore të hershëm kryhen në faqen zyrtare web në formën digjitale të aplikimit sipas germës "a" të pikës 2, të nenit 14, të kësaj Rregulloreje. Forma digjitale e aplikimit që plotësohet nga aplikanti, përmban fushat si vijon:

- Të dhënat e aplikantit;
- Numri i identifikimit të mjetit;
- Vendi nga importohet mjeti;
- Dokumenti teknik i origjinës;
- Dokumente të tjera;
- Fotot e mjetit.

Sektori i Homologimit dhe Verifikimit të Specializuar merr në shqyrtim aplikimin përmes platformës CRM dhe verifikon të dhënat e deklaruara nga aplikuesi, sipas kritereve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 6, dhe jep përgjigjen përfundimtarë sipas pikës 1, të nenit 11, të kësaj Rregulloreje. Përgjigja duhet të jepet brenda 1 (një) dite pune.

2. Aplikimi për fitimin e statusit "RETRO":

Aplikimi për fitimin e statusit "RETRO" kryhen në faqen zyrtare web në formën digjitale të aplikimit sipas germës "b", të pikës 2, të nenit 14, të kësaj Rregulloreje. Forma digjitale e aplikimit që plotësohet nga aplikanti, përmban fushat si vijon:

- Të dhënat e zotëruesit;
- Karakteristikat e mjetit;
- Dokumentacionin e mjetit;
- Fotografitë e mjetit;
- Vetëdeklarimin mbi statusin e mjetit dhe gjendjen e tij.



Sektori "RETRO" merr në shqyrtim aplikimin përmes platformës CRM dhe verifikon të dhënat e deklaruara nga aplikuesi, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 6, të kësaj Rregulloreje dhe jep përgjigjen për vijimin e procedurës së mëtejshme sipas germës "a" të pikës 2, të nenit 11, të kësaj Rregulloreje.

3. Aplikimi për regjistrimin e përkohshëm të mjeteve "Future Classics":

Aplikimi për regjistrimin e përkohshëm të mjeteve "Future Classics" kryhet në mënyrë të njëjtë me pikën 2, të këtij neni.

Neni 16

Verifikimi i mjetit nga Komisioni "RETRO"

Pas verifikimit të dokumentacionit dhe aprovimit paraprak nga specialisti i sektorit "RETRO", të një mjeti rrugor të hershëm apo një mjeti "Future Classics" me vjetërsi nga 25 deri në 29 vite, dosja i përcillet Komisionit, për vijimin me fazën e verifikimit fizik dhe teknik.

Verifikimi fizik dhe teknik i mjeteve rrugore të hershme, kryhet gjatë shqyrtimit të statusit "RETRO" në regjistrimin e parë të mjetit si dhe në çdo rast të rinovimit të statusit "RETRO" pas përfundimit të vlefshmërisë së Certifikatës së Njohjes.

A. Verifikimi fizik:

Komisioni "RETRO" kryen kqyrjen fizike të mjetit, identifikimin e treguesve teknik të tij, si dhe me anë të inspektimit vizual verifikimin e sistemeve dhe komponentëve të mjetit sa i përket nivelit të ruajtjes së origjinalitetit, llojit të modifikimeve, restaurimeve dhe rikonstruktimeve.

B. Verifikimi teknik:

Vlerësimi i gjendjes teknike të sistemeve dhe komponentëve të mjetit do të kryhet sipas metodës së testimit vizual, ndërsa për autoveturat vetëm për sistemin e frenimit do të kryhet testimi në pajisjen e frenave ku do të matet rezultati i eficiencës së forcës totale të frenimit të mjetit (rezultati i testit do të bashkëlidhet me Formularin R02).

Testimi i sistemit të frenimit me pajisje do të kryhet vetëm për mjetet që janë të pajisura me sistem frenimi konvencional. Për mjetet me sisteme frenimi të ndryshme, të papërshtatshme për testim me pajisje, si dhe për mjetet 4x4, testimi i frenimit do të kryhet me dekselerometër. Për mjetet për të cilat testimi i frenimit nuk mund të kryhet me pajisje, komisioni është i detyruar të japë një përshkrim të llojit të sistemit të frenimit si dhe të argumentojë arsyen e pamundësisë së testimit duke e pasqyruar atë në rubrikën "Shënime".

Testimi i sistemit të frenimit me pajisje dhe me dekselerometër, do të kryhet nga specialisti i kontrollit teknik në mbikëqyerjen e Komisionit Retro, raporti i testimit me pajisje dhe vlerat e dekselerometrit, do të nënshkruhen nga të dyja palët.

Pas verifikimeve fizike dhe teknike për çdo sistem dhe komponent, si edhe pasi të përcaktohen kategoritë e vjetërsisë, teknike dhe të ruajtjes së formës, nga ana e Komisionit "RETRO" jepet konkluzion nëse mjeti e fiton apo jo statusin "RETRO", ku secili anëtar nënshkruan në



Formularin R02 sipas vendimmarrjes individuale. Statusi "RETRO" i jepet një mjeti rrugor të hershëm kur të paktën 3 (tre) anëtarë të Komisionit kanë dhënë miratimin nëpërmjet nënshkrimit në Formularin R02. Në rast se ndonjë prej anëtarëve refuzon dhënien e statusit "RETRO", atëherë duhet të plotësojë me shkrim gjithashtu arsyet e refuzimit.

Në rast se mjeti nuk e fiton statusin "RETRO", nga ana e Komisionit jepen me shkrim arsyet e refuzimit. Zotëruesi i mjetit duhet t'i nënshtrohet procedurës së ri-kontrollit nga Komisioni "RETRO", brenda 90 ditësh nga dita e refuzimit, për të vlerësuar mangësitë e evidentuara. Në rast se nuk paraqitet brenda 90 ditëve, mjeti do t'i nënshtrohet kontrollit nga e para, kundrejt tarifës së vlerësimit për herë të parë.

Komisioni "RETRO" mund të shqyrtojë një aplikim për një mjet pa dokumentacion provë të origjinës, vetëm pasi aplikuesi ka plotësuar Formularin e Vetëdeklarimit R01, nëpërmjet të cilit aplikuesi merr përsipër të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë administrative, penale dhe civile, që vijnë si rrjedhojë e zotërimit të mjetit.

Formularët plotësohen gjatë verifikimit fizik të mjetit, në prani të përfaqësuesit të sektorit "RETRO" që ka në shqyrtim aplikimin.

Kriteret dhe fushat objekt verifikimi janë si më poshtë:

1. Identifikimi i treguesve teknik të mjetit.
 - 1.01. Data e regjistrimit të parë, B
 - 1.02. Viti i prodhimit, B.1
 - 1.03. Marka, D.1
 - 1.04. Tipi/Varianti/Versioni, D.2
 - 1.05. Emërtimi tregtar, D.3
 - 1.06. Numri i identifikimit (nr. shasisë), E
 - 1.07. Masa maksimale teknike (kg), F.1
 - 1.08. Masa max. e lejuar për qarkullim (kg), F.2
 - 1.09. Masa max. e kompleksit, e lejuar (kg), F.3
 - 1.10. Masa bosh (kg), G
 - 1.11. Data e lëshimit të Certifikatës së Njohjes, I
 - 1.12. Afatet e vlefshmërisë së Certifikatës së Njohjes,
 - 1.13. Kategoria ndërkombëtare, J
 - 1.14. Destinacioni/Përdorimi , J.1
 - 1.15. Kodi i karrocërisë (BE), J.2
 - 1.16. Numri i miratimit të tipit, K
 - 1.17. Numri i miratimit individual, K.1
 - 1.18. Numri i akseve, L
 - 1.19. Distanca aksiale (mm), M



- 1.20. Kapaciteti (cilindrata) motorit (cm³), P.1
- 1.21. Fuqia maksimale motorit (KW), P.2
- 1.22. Lloji karburantit ose burimi energjisë, P.3
- 1.23. Xhirot nominale të motorit (rrot/min), P.4
- 1.24. Numri identifikimit motorit, P.5
- 1.25. Raporti i fuqisë me peshën (K/kg), Q
- 1.26. Ngjyra (ngjyra bazë/ngjyra e dytë), R
- 1.27. Numri ndenjësve, përfshi të drejtuesit, S.1
- 1.28. Numri vendeve të qëndrimit në këmbë, S.2
- 1.29. Kapaciteti i vendeve (S.1+S.2), S
- 1.30. Shpejtësia maksimale (km/orë), T
- 1.31. Niveli zhurmës në qëndrim [dB(a)], U.1
- 1.32. Niveli zhurmës në regj. normal të mot. (min-1), U.2
- 1.33. Niveli zhurmës në lëvizje [dB(a)], U.3
- 1.34. Sasia e CO që shkarkohet (g/km), V.1
- 1.35. Sasia e HC që shkarkohet (g/km), V.2
- 1.36. Sasia e NOx që shkarkohet (g/km), V.3
- 1.37. Sasia e HC+NOx që shkarkohet (g/km), V.4
- 1.38. Sasia e grimcave që shkarkohen (g/km), V.5
- 1.39. Koeficienti i korrigjimit të absorbimit (m-1), V.6
- 1.40. Sasia e CO₂ që shkarkohet (g/km), V.7
- 1.41. Konsumi kombinuar i karburantit (l/100 km), V.8
- 1.42. Treguesi i kategorisë mjedisore, V.9
- 1.43. Kapaciteti i rezervuarit lëndës djegëse (litra),
- 1.44. Afati i mbarimit të Certifikatës së Njohjes, X
- 1.45. Numri cilindrave,
- 1.46. Numri i dyerve,
- 1.47. Gjatësia (mm),
- 1.48. Gjerësia (mm),
- 1.49. Lartësia (mm),
- 1.50. Lloji i kutisë së shpejtësisë,
- 1.51. Përmasa e gomës në aksin e parë,
- 1.52. Përmasa e gomës në aksin e dytë,
- 1.53. Përmasa e gomës në aksin e tretë,
- 1.54. Pajisur me ganxhë?,
- 1.55. Ardhur nga,
- 1.56. Statusi i mjetit,



- 1.57. Dt. çregjistrimit të përhershëm,
1.58. Dt. çregjistrimit të përkohshëm.

Nga të dhënat e mësipërme komisioni do të plotësojë vetëm të dhënat e disponueshme. Pronari i mjetit ka detyrimin të tregojë dhe të mirëmbajë vendin ku është stampuar numri i identifikimit. Mungesa e numrit të shasisë e bën të pamundur identifikimin e mjetit dhe sjell refuzim.

Nëse “Viti i prodhimit” nuk përcaktohet qartë në tabelën identifikuese të mjetit, dokumentacionin teknik të tij apo aktet e tjera provuese, do të shfrytëzohen manualët teknike bazuar në numrin e identifikimit të mjetit. Në rast se në manualët teknike nuk tregohet viti i prodhimit por periudha për të cilën është prodhuar seria e atij modeli/tipi atëherë si vit prodhimi do të konsiderohet viti i fundit i prodhimit të serisë.

2. Shasia dhe karrocëria.

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të numrit të identifikimit, komponentëve të shasisë dhe karrocërisë, strukturës së shasisë dhe karrocërisë, gjendjes teknike të tyre, origjinalitetit/autenticitetit dhe karakteristikave të bojës së mjetit.

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Paraqet ndryshime në strukturën e shasisë dhe/apo të kabinës, apo ndryshime në materialet që janë parashikuar në fabrikim për atë model. Aplikimi do të refuzohet edhe nëse mjeti paraqet vetëm modifikime të pjesshme të strukturës trupore të cilat nuk ruajnë formën origjinale.
- b) Ka ndryshime thelbësore të formave të karrocërisë dhe të materialeve të përdorura për të prodhuar panelet e karrocërisë. Për shembull, aplikimi do të refuzohet nëse mjeti në origjinë ka qenë “coupé”, por paraqitet për shqyrtim si “cabriolé”.
- c) Ka prani të ndryshkut korroziv në shasi, kabinë dhe panelet e karrocërisë. Vetëm nëse riparimi dhe restaurimi do të jetë i tillë që të eliminojë ndryshkun korroziv dhe të rikthejë mjetin sa më afër gjendjes fillestare do të konsiderohet i pranueshëm nga Komisioni “RETRO”.
- d) Ka aplikuar një bojë që nuk përfshihet në spektrin e ngjyrave të asaj gjenerate, të atij modeli. Kriter i domosdoshëm është ruajtja e ngjyrës origjinale të mjetit, ose ngjyrë që t’i përkasë spektrit të ngjyrave të parashikuara për atë model, e cila do të konsiderohet e pranueshme nga Komisioni “RETRO”.
- e) Shasia dhe karrocëria ose komponentët e tij janë të konsumuar ose të dëmtuar në mënyrë të tillë që cenojnë funksionimin, integritetin ose sigurinë e mjetit (p.sh. xhoko mbi normë,



shmangie aksiale/radiale, nyje të pafiksuara, amortizim i tepërt, thyerje/krisje, korrozion i avancuar, deformime).

3. Motori dhe kutia e shpejtësisë.

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të numrit të identifikimit të motorit dhe/ose kutisë së shpejtësisë, elementëve strukturor, karakteristikave teknike të tyre (nr. cilindrave, nr. i raporteve të kambios, etj.), komponentëve përbërës të dukshëm, gjendjes teknike të tyre dhe origjinalitetit/autenticitetit.

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Mjeti nuk përdor motorin/kutinë e shpejtësisë origjinale. Bëjnë përjashtim rastet kur, për shkak të mungesës apo vështirësisë në gjetjen e një apo më shumë pjesëve të këmbimit, bëhet i pamundur restaurimi i motorit/kutisë së shpejtësisë origjinale. Në këto raste, zëvendësimi i motorit/kutisë së shpejtësisë do të konsiderohet i vlefshëm (pranueshëm) nga Komisioni “*RETRO*” vetëm nëse motori/kutia e shpejtësisë zëvendësuese ka qenë e parashikuar për versionin, modelin dhe gjeneratën e mjetit objekt verifikimi.
- b) Motori/kutia e shpejtësisë ka pësuar modifikime thelbësore, duke përdorur pjesë që nuk janë parashikuar për atë model në periudhën e fabrikimit, me synim ndryshimin e karakteristikave teknike dhe rritjen e performancës së mjetit.
- c) Motori/kutia e shpejtësisë dhe pjesët e tij përbërëse janë jo-funksionale ose të amortizuara ndjeshëm gjatë procesit të verifikimit fizik të mjetit.
- d) Motori dhe kutia e shpejtësisë ose komponentët e tij janë të konsumuar ose të dëmtuar në mënyrë të tillë që cenojnë funksionimin, integritetin ose sigurinë e mjetit (p.sh. xhoko mbi normë, shmangie aksiale/radiale, nyje të pafiksuara, amortizim i tepërt, thyerje/krisje, korrozion i avancuar, deformime).

4. Sistemi i ndezjes dhe sistemi i furnizimit (ushqimit).

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të karakteristikave teknike të sistemit të ndezjes/ushqimit, komponentëve përbërës të dukshëm, gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të tyre.

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Konstatohet që sistemin e ndezjes/furnizimit nuk është origjinal, apo sistemi është modifikuar/tjetërsuar dhe nuk përputhet me specifikat e parashikuara gjatë fabrikimit. Bëjnë përjashtim rastet kur, për shkak të mungesës apo vështirësisë në gjetjen e një apo më shumë pjesëve të këmbimit, bëhet i pamundur restaurimi i sistemit origjinal. Në këto raste, zëvendësimi i pjesëve përbërëse të sistemit do të do të konsiderohet i pranueshëm nga Komisioni *RETRO*, vetëm nëse pjesët zëvendësuese të përdorura kanë qenë të parashikuara për versione të tjera të asaj gjenerate.
- b) Sistemi i ndezjes/furnizimit dhe pjesët e tij përbërëse janë jo-funksionale apo të amortizuara ndjeshëm gjatë procesit të verifikimit fizik të mjetit.



- c) Sistemi ose komponentët e tij janë të konsumuar ose të dëmtuar në mënyrë të tillë që cenojnë funksionimin, integritetin ose sigurinë e mjetit (p.sh. xhoko mbi normë, shmangie aksiale/radiale, nyje të pafiksuara, amortizim i tepërt, thyerje/krisje, korrozion i avancuar, deformime).

5. Disqet dhe Gomat.

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të karakteristikave teknike (materiali, modeli, përmasat, ngjyra e disqeve) të disqeve dhe gomave, gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të tyre.

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Disku është zëvendësuar me një model të ndryshëm nga ai i fabrikimit të mjetit. Përrjashtohen nga ky rregull rastet kur, për shkak të materialit të diskut (*p.sh. dru*) dhe vjetërsisë së modelit, disku origjinal është i pamundur të restaurohet dhe nuk mund të gjendet një disk zëvendësues i të njëjtit model. Në këto raste do të konsiderohet i pranueshëm nga Komisioni *RETRO*, vendosja e një disku zëvendësues që është përdorur për versione të tjera të atij modeli apo për modele të tjera të asaj marke, me kushtin që rrezja e diskut zëvendësues të jetë jo më shumë se 2 (*dy*) inç më e madhe se rrezja e diskut origjinal.
- b) Disku është ngjyrosur, kur kjo nuk ka qenë e parashikuar në modelin origjinal.
- c) Disku ka dëmtime që ndikojnë në sigurinë dhe qarkullimin normal në rrugë. Ky kusht vlen edhe për gomat e mjetit.
- d) Gjerësia dhe rrezja e diskut/gomës nuk përputhen me përmasat e parashikuara në origjinë.
- e) Janë vendosur pjesë shtesë që krijojnë hapësirë ndërmjet diskut të gomës dhe tamburit (*spesor disku*).
- f) Disqet dhe gomat ose komponentët e tij janë të konsumuar ose të dëmtuar në mënyrë të tillë që cenojnë funksionimin, integritetin ose sigurinë e mjetit (p.sh. xhoko mbi normë, shmangie aksiale/radiale, nyje të pafiksuara, amortizim i tepërt, thyerje/krisje, korrozion i avancuar, deformime).

6. Sistemi i drejtimit.

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të llojit të sistemit të drejtimit, zëvendësimit të krahut të sistemit të drejtimit, komponentëve (timoni, mekanizmit të transmetimit, përforcuesve ndihmës, etj.), gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të tij.

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Mjeti ka të ndryshuar krahun e timonit.
- b) Mjeti ka të ndryshuar llojin e sistemit të drejtimit (*p.sh., nga mekanik në hidraulik*). Do të konsiderohet që ndryshimi është i pranueshëm nga Komisioni *RETRO*, nëse sistemi i ri i drejtimit mund të gjendet në versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit.
- c) Sistemi i drejtimit dhe pjesët e tij përbërëse janë jo-funksionale apo të amortizuara ndjeshëm gjatë procesit të verifikimit fizik, duke mos garantuar qarkullimin e sigurt të mjetit në rrugë.



- d) Sistemi ose komponentët e tij janë të konsumuar ose të dëmtuar në mënyrë të tillë që cenojnë funksionimin, integritetin ose sigurinë e mjetit (p.sh. xhoko mbi normë, shmangie aksiale/radiale, nyje të pafiksuara, amortizim i tepërt, thyerje/krisje, korrozion i avancuar, deformime).

7. Kabina dhe Tapiceria.

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të elementëve strukturor të kabinës dhe tapicerisë, materialeve të përdorur në to, gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të tyre, duke përfshirë edhe verifikimin nëse ka përdorim të pajisjeve shtesë.

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Restaurimi i tapicerisë dhe i ndenjësive bëhet duke devijuar nga veçoritë dalluese të brendisë së atij versioni/modeli specifik. Këtu përfshihet materiali i përdorur (p.sh., lëkura në vend të pëlhurës), forma/ngjyra e tegelave, si dhe çdo element tjetër karakterizues i restaurimit, që e largon brendinë e kabinës nga pamja e saj origjinale.
- b) Komponentë si: timoni, leva e sinjaleve, leva e marshit, pedali/leva e frenave të parkimit, mekanizmi i hapjes së xhamave anësor mekanik/elektrik, paneli i kontrollit dhe elementë të tjerë të kabinës paraqesin dëmtime dhe/apo elemente korrozioni.
- c) Janë montuar apo përshtatur pajisje, teknologjia e së cilave nuk ka qenë e parashikuar gjatë fabrikimit për mjetin në shqyrtim, apo për versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit.
- d) Kabina dhe tapiceria ose komponentët e tij janë të konsumuar ose të dëmtuar në mënyrë të tillë që cenojnë funksionimin, integritetin ose sigurinë e mjetit (p.sh. xhoko mbi normë, shmangie aksiale/radiale, nyje të pafiksuara, amortizim i tepërt, thyerje/krisje, korrozion i avancuar, deformime).

8. Sistemi i sinjalizimit/ndriçimit.

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të karakteristikave teknike (lloji, modeli, ngjyra e dritave, teknologjia) të sistemit të sinjalizimit/ndriçimit, komponentëve (fenerë, indikatorë, llambat etj.), gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të tyre.

Mjeti refuzohet, nëse:

- a) Gjatë procesit të restaurimit, fenerët, indikatorët e drejtimit dhe/apo dritat e pasme kanë pësuar ndryshime që nuk kanë qenë të parashikuara gjatë fabrikimit për atë model.
- b) Sistemi i ndriçimit është pasuruar me elementë që nuk kanë qenë parashikuar për atë model (p.sh., drita mjegulle shtesë). Do të konsiderohet i pranueshëm nga Komisionit Retro, kur ky ndryshim ka qenë i parashikuar për versione specifike të asaj gjenerate të mjetit.
- c) Ndriçimi i mjetit bëhet me llamba apo teknologji që nuk përputhet me specifikat e modelit. Ky rregull vlen edhe në rastet kur në treg ofrohen ndriçues me teknologji të re, që janë fabrikuar posaçërisht për modelin përkatës.
- d) Sistemi i ndriçimit dhe pjesët e tij përbërëse janë jo-funksionale apo të dëmtuara gjatë procesit të verifikimit fizik, duke mos garantuar qarkullimin e sigurt të mjetit në rrugë.
- e) Nga kontrolli vizual, konstatohet se sistemi dhe komponentët e tij ndodhen në gjendje teknike të pasigurt për qarkullim.

9. Sistemi i shikimit prapa.



Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të llojit (pozicionimi, sasia e komponentëve etj.) të sistemit të shikimit prapa, komponentëve (pasqyrat etj.), gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të tij.

Mjeti refuzohet, nëse:

- a) Gjatë procesit të restaurimit, pasqyrat kanë pësuar ndryshime që nuk kanë qenë të parashikuara gjatë fabrikimit për atë model (p.sh., lysterja e kapakut të pasqyrës, kur në origjinë ka qenë i kromuar).
- b) Pasqyra është zëvendësuar me një model tjetër. Do të konsiderohet e pranueshme nga Komisioni “*RETRO*”, kur pasqyra zëvendësuese ka qenë e parashikuar për versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit. Për rastet kur pasqyra zëvendësuese e të njëjtit model nuk mund të gjendet për shkak të vjetërsisë, do të lejohet përdorimi i një pasqyre të prodhuar për modele të së njëjtës periudhë kohore.
- c) Numri i pasqyrave të jashtme të mjetit ka ndryshuar nga specifikat e origjinës.
- d) Pozicioni i pasqyrave të jashtme ka ndryshuar.
- e) Nga kontrolli vizual, konstatohet se sistemi dhe komponentët e tij ndodhen në gjendje teknike të pasigurt për qarkullim.

10. Sistemi i Sospensioneve (Amortizimit).

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të llojit të sistemit sospensioneve (MacPherson, etj.), komponentëve (elementët shuarës, elementë drejtues, elementët stabilizues etj.), gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të tij.

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Mungesa e amortizatorëve ose sustave.
- b) Gjatë procesit të rikonstruktimit, sustat apo amortizatorët kanë pësuar ndryshime që nuk kanë qenë të parashikuara gjatë fabrikimit për atë model.
- c) Amortizatorët ose sustat janë zëvendësuar me një model tjetër. Do të konsiderohet i pranueshëm nga Komisioni “*RETRO*”, kur amortizatori ose susta zëvendësuese ka qenë e parashikuar për versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit. Për rastet kur amortizatori ose susta zëvendësuese e të njëjtit model nuk mund të gjendet për shkak të vjetërsisë, do të lejohet përdorimi i një amortizatori ose susta të prodhuar për modele të së njëjtës periudhë kohore.
- d) Shenja të dukshme të korrozionit në krahët drejtues, stabilizues, amortizatorë, susta, nyje apo dëmtim/amortizim i dukshëm i tyre.
- e) Ndryshim i pozicionit të krahëve drejtues, stabilizues, amortizatorëve, sustave, nyjeve nga ato origjinale.
- f) Nga kontrolli vizual, konstatohet se sistemi dhe komponentët e tij ndodhen në gjendje teknike të pasigurt për qarkullim.



11. Sistemi i frenimit.

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të llojit të sistemit të frenimit (me tamburë, me disk, me dy konture, me apo pa ABS, etj.), komponentëve përbërës, verifikimit me pajisje të performancës së frenimit, gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të këtij sistemi.

Efektiviteti i sistemit të frenimit të automjeteve do të matet për frenat e shërbimit dhe frenat e parkimit, si vijon:

- Efektiviteti i frenave të shërbimit dhe parkimit do të matet në pajisje testimi frenash ose nëse kjo është e pamundur, matja do të kryhet me anë të një instrumenti regjistruar ngadalësimi (dekselerometër).

- Në rastin e testimit me pajisje, llogaritja e eficiencës do të kryhet me formulën:

$$\text{Eficiencia (\%)} = \frac{\sum F_{\text{rrote}} \cdot 1000}{m \cdot g} \cdot 100$$

F_{rrote} - Forca në rrotë shprehet në [kN].

m – masa e mjetit në momentin e matjes [kg] (gjatë matjes, mjeti nuk duhet të jetë me ngarkesë).

g – nxitimi i rënies së lirë (9.81 m/s²).

Matja do të kryhet sipas instruksioneve të pajisjes së testimit duke marrë në konsideratë që pajisja bazohet mbi formulën e mësipërme dhe kryen mesatarizimin e rezultatit të akteve ku aplikohet mekanizmi frenues.

- Në rastin e testimit me dekselerometër, llogaritja e eficiencës do të kryhet në bazë të instruksioneve teknike të prodhuesit të pajisjes.
- Vlerat e lejuara të efektivitetit të sistemit të frenimit do të jenë:
 - Efektiviteti i lejuar i frenave të shërbimit duhet të jetë jo më i vogël se [50%].
 - Efektiviteti i lejuar i frenave të parkimit duhet të jetë jo më i vogël se [16%].

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Mungesa e komponentëve.
- b) Gjatë procesit të rikonstruktimit, komponentë kanë pësuar ndryshime që nuk kanë qenë të parashikuara gjatë fabrikimit për atë model.
- c) Kur komponentët përbërës janë zëvendësuar me modele të tjera. Do të konsiderohet i pranueshëm nga Komisioni “RETRO”, kur komponentët e sistemit të frenimit kanë qenë parashikuar për versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit.
- d) Shenja të dukshme të korrozionit në komponentët përbërës.
- e) Nga kontrolli vizual, konstatohet se sistemi dhe komponentët e tij ndodhen në gjendje teknike të pasigurt për qarkullim.



12. Sistemi i shkarkimit.

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të llojit të sistemit të shkarkimit, komponentëve përbërës, gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të tyre.

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Mungesa e komponentëve.
- b) Gjatë procesit të rikonstruktimit, komponentë kanë pësuar ndryshime që nuk kanë qenë të parashikuara gjatë fabrikimit për atë model.
- c) Kur komponentët përbërës janë zëvendësuar me modele të tjera. Do të konsiderohet i pranueshëm nga Komisioni “*RETRO*”, kur komponentët e sistemit të shkarkimit kanë qenë parashikuar për versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit.
- d) Shenja të dukshme të korrozionit në komponentët përbërës.
- e) Nga kontrolli vizual, konstatohet se sistemi dhe komponentët e tij ndodhen në gjendje teknike të pasigurt për qarkullim.

13. Organet e transmetimit të lëvizjes.

Vlerësimi do të bazohet në verifikimin vizual të llojit të organeve të transmetimit të lëvizjeve, komponentëve përbërës, gjendjes teknike dhe origjinalitetit/autenticitetit të tyre.

Mjeti refuzohet nëse:

- a) Mungesa e komponentëve.
- b) Gjatë procesit të rikonstruktimit, komponentë kanë pësuar ndryshime që nuk kanë qenë të parashikuara gjatë fabrikimit për atë model.
- c) Kur komponentët përbërës janë zëvendësuar me modele të tjera. Do të konsiderohet i pranueshëm nga Komisioni “*RETRO*”, kur komponentet e organeve të transmetimit kanë qenë parashikuar për versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit.
- d) Shenja të dukshme të korrozionit në komponentët përbërës.
- e) Organet e transmetimit të lëvizjes ose komponentët e tij janë të konsumuar ose të dëmtuar në mënyrë të tillë që cenojnë funksionimin, integritetin ose sigurinë e mjetit (p.sh. xhoko mbi normë, shmangie aksiale/radiale, nyje të pafiksuar, amortizim i tepërt, thyerje/krisje, korrozion i avancuar, deformime).

Neni 17

Administrimi i dokumentacionit

1. Sektori “*RETRO*” administron të gjithë dokumentacionin e mjetit të paraqitur nga zotëruesi i mjetit gjatë verifikimit nga Komisioni, i cili duhet të jetë në origjinal, si dhe dokumentacionin e vlerësimit të Komisionit *RETRO*.
2. Në rastin kur mjeti nuk e përfiton statusin “*RETRO*” dhe zotëruesi i mjetit nuk pranon të nënshkruajë akt-konstatimin, Komisioni “*RETRO*” dokumenton mangësitë teknike dhe



estetike të konstatuara përmes fotografive të realizuara gjatë verifikimit. Fotografitë bashkëlidhen me akt-konstatimin e verifikimit dhe bëhen pjesë e dosjes së mjetit. Dosja e mjetit arkivohet pranë sektorit “RETRO” në DPSHTRR.

3. Pas vlerësimit nga komisioni, përfaqësuesi i sektorit “RETRO” kryen veprimet si më poshtë:
 - Administron dokumentacionin në dosje;
 - Kryen inventarizimin e dosjes duke mbajtur procesverbalin shoqërues, i cili nënshkruhet nga kryetari i Komisionit, përfaqësuesi i sektorit “RETRO” dhe zotëruesi i mjetit;
 - Plotëson të dhënat në Regjistrin *RETRO*.
 - Dërgon dosjen e inventarizuar me shkresë përcjellëse në Sektorin e Arkivit të Dokumentacionit të Mbyllur, në DPSHTRR.
4. Përmbajtja e dosjes së mjetit do të jetë:
 - a. Kur mjeti fiton statusin “RETRO”, dokumentacioni pjesë e dosjes së mjetit do të jetë:
 - Dokumentacioni në origjinal i dorëzuar dhe i nënshkruar nga zotëruesi i mjetit:
 - Dokumentacioni i aplikimit;
 - Dokumentat e origjinës;
 - Fotokopje të nënshkruar të dokumentit të identifikimit personal;
 - Dokumentin e fitimit të pronësisë së mjetit;
 - Deklaratën doganore;
 - Formularët R01, R02 dhe R03 të plotësuar dhe nënshkruar.
 - Fotografitë e numrit të identifikimit.
 - Fotografitë e mjetit.
 - Mandati i pagesës për vlerësimin në Komision (në rastet e ri-kontrollit do të bashkëlidhet edhe mandati për pagesën e ri-kontrollit).
 - Fotokopje e Certifikatës së Njohjes dhe librit të udhëtimit.
 - b. Kur mjeti nuk e fiton statusin “RETRO” dokumentacioni pjesë e dosjes së mjetit do të jetë:
 - Dokumentacioni i aplikimit.
 - Formulari R02 i plotësuar me arsyet e refuzimit.
 - Mandati i pagesës për vlerësimin në Komision.
 - Fotokopje të nënshkruar të dokumentit të identifikimit personal;
 - Fotografitë e mangësive të konstatuara (vetëm për rastet sipas pikës 2, të këtij neni).
 - Fotografitë e mjetit.
 - Formularin R01 (kur nuk ka dokumentacion).
5. Zotëruesit të mjetit i lind e drejta e ankimit me shkrim pranë DPSHTRR-së, mbi vendimin e Komisionit “RETRO” për rastet e refuzimit sipas pikës 2, të këtij neni. Ankimimi duhet të përfshijë të dhënat e aplikuesit, referencën e vendimit, arsyet e kundërshtimit dhe dokumentet/fotografitë mbështetëse të mjetit. Ankimimi shqyrtohet nga struktura përgjegjëse e ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, të cilët verifikojnë dokumentacionin bashkëlidhur ankimit dhe nëse nevojitet, kryejnë rivlerësim fizik të mjetit në prani të Komisionit “RETRO”. Zotëruesi i mjetit njoftohet me shkrim për vendimin mbi shqyrtimin e ankimit dhe e drejta për ankimimin e mëtejshëm në organet gjyqësore brenda 10 ditëve nga marrja dijeni për vendimin.



Neni 18

Mospërputhja e të dhënave të pronësisë

Nëse konstatohet se ka mospërputhje në të dhënat e pronësisë (zotëruesi i mjetit në sistemin eDPSHTRR rezulton të jetë i ndryshëm nga aplikuesi), bëhet refuzimi i aplikimit me arsyetimin përkatës. Shqyrtimi i mëtejshëm i aplikimit mund të vijojë vetëm nëse aplikuesi paraqet një dokument të vlefshëm, që provon kalimin e të drejtës së pronësisë nga pronari apo trashëgimtarët e pronarit drejt tij, në një nga format e parashikuara në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 19

Mjetet në zotërim të institucioneve publike apo që administrohen nga Shteti

1. Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 03.04.1993 “Për kalimin e objekteve dhe të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe të institucioneve shtetërore”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, institucionet shtetërore që kanë në inventarin e tyre një mjet rrugor të prodhuar të paktën 30 (tridhjetë) vite më parë, ia përcjellin këtë mjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të verifikuar nëse mjete përmbush kriteret historike për të fituar statusin “RETRO”.
2. Rregullat që do të zbatohen sa i përket verifikimit të mjeteve në zotërim të institucioneve publike apo që administrohen nga shteti, janë:
 - a. Institucioni përkatës kryen aplikimin sipas pikës 2, të nenit 14, duke deklaruar adresën elektronike zyrtare të institucionit.
 - b. Sektori “RETRO” kryen vlerësimin paraprak të dokumentacionit të përcjellë nga ana e institucionit shtetëror, në platformën CRM.
 - c. Nëse mjete nuk plotëson kriteret e nevojshme për t’u konsideruar mjet me rëndësi historike, vijohet me procedurën e heqjes së përhershme nga qarkullimi (nxjerrjes jashtë përdorimit), nëpërmjet një shkrese lëshuar nga DPSHTRR, sipas nenit 18 “Heqja e përhershme e mjeteve nga qarkullimi” të Udhëzimit nr. 4, datë 28.06.2019, të MIE-s “Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore”, i ndryshuar, ku sqarohet procedura që ndiqet për heqjen e përhershme nga qarkullimi.
 - d. Nëse mjete plotëson kriteret sipas nenit 6, të kësaj Rregulloreje, vijohet me vlerësimin nga Komisioni “RETRO” për fitimin e statusit “RETRO”.
 - e. Nëse Komisioni “RETRO” konstaton se mjete rrugor përmbush kushtet teknike për të fituar statusin “RETRO”, mjete do të vijojë me procedurat e regjistrimit si mjet “RETRO” në emër të institucionit.



KREU V
CERTIFIKIMI, REGJISTRIMI DHE QARKULLIMI

Neni 20
Formularët “R”

1. Formulari R01:
 - a. Është dokument vetëdeklarimi që plotësohet nga zotëruesi i mjetit rrugor të hershëm në mungesë të dokumentacionit të origjinës, mbi shqyrtimin e kërkesës për fitimin e statusit “RETRO”, sipas shtojcës III.
 - b. Përgatitet nga Sektori “RETRO” dhe plotësohet nga zotëruesi i mjetit gjatë verifikimit nga Komisioni “RETRO”
 - c. Formulari fizik nënshkruhet nga zotëruesi i mjetit dhe kryetari i komisionit “RETRO”.

2. Formulari R02.
 - a. Dokument (akt-konstatimi) që plotësohet nga Komisioni “RETRO” për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të një mjeti rrugor të hershëm, me qëllim dhënien ose jo të statusit “RETRO”, sipas shtojcës V.
 - b. Formati gjenerohet nga platforma CRM.
 - c. Çdo formular ka një numër serial unik (alfanumerik) që gjenerohet automatikisht nga platforma CRM.
 - d. Të dhënat që përmban, janë:
 - Identifikimi i treguesve teknik të mjetit (sipas pikës 1, të nenit 16, të kësaj rregulloreje);
 - Vlerësimi i komponentëve dhe sistemeve të mjetit (sipas pikave nga 2 deri 13, të nenit 16, të kësaj rregulloreje):
 - i. Vlerësim i gjendjes teknike dhe fizike të mjetit;
 - ii. Vlerësim mbi origjinalitetin/autenticitetin.
 - Klasifikimi sipas kategorive të treguara në nenin 8, të kësaj rregulloreje.
 - Konkluzionet e Komisionit.
 - e. Formulari fizik nënshkruhet nga Komisioni “RETRO” dhe bëhet pjesë e dosjes.

3. Formulari R03:
 - a. Është akt konstatim që plotësohet nga kryetari i komisionit “RETRO”, mbi përmbushjen e kriterëve dhe miratimin e statusit “RETRO” të një mjeti rrugor të hershëm dhe vijimin e procedurës për regjistrim si mjet “RETRO”, sipas shtojcës IV.
 - b. Ka një numër serial progresiv.
 - c. Formulari fizik nënshkruhet nga kryetari i komisionit dhe zotëruesi i mjetit.



Neni 21

Certifikata e Njohjes

1. Certifikata e Njohjes është një dokument zyrtar i lëshuar nga DPSHTRR që vërteton statusin “*RETRO*” të mjetit të vlerësuar nga Komisioni “*RETRO*” dhe përmban të dhënat, si më poshtë:
 - a. Marka (D1);
 - b. Modeli/tipi/emërtimi tregtar (D2);
 - c. Për mjetet “*Replica*” të regjistruara sipas pikës 4, të nenit 6, të kësaj Rregulloreje, do të evidentohen me shënimin “*Replica*” në fushën (D2);
 - d. Vendi i origjinës (qyteti dhe shteti);
 - e. Targa e mjetit (A);
 - f. Numri i identifikimit të mjetit (E);
 - g. Viti i prodhimit (B1);
 - h. Për mjetet “*Replica*”, nuk do të shënohet viti i modelit të imituar, por viti i montimit efektiv të mjetit.
 - i. Vëllimi motorit (P.1);
 - j. Lënda djegëse ose burimi i energjisë (P.3);
 - k. Numri i cilindrave;
 - l. Përmasat e mjetit;
 - m. Përmasat e gomave;
 - n. Gjeneralitetet e pronarit të mjetit *RETRO*: Mbiemri (C.2.1), Emri (C.2.2), Adresa e pronarit (C.2.3);
 - o. Kodi i kategorizimit të mjetit, sipas shtojcës XII, të VKM Nr.153, dt. 07.04.2000 të ndryshuar;
 - p. Lloji i kutisë së shpejtësisë;
 - q. Data e lëshimit të Certifikatës së Njohjes (I);
 - r. Afati i mbarimit të Certifikatës së Njohjes (X);
 - s. Kategoria ndërkombëtare (J);
 - t. Numri i serisë së Certifikatës së Njohjes.

Certifikata e Njohjes nënshkruhet dhe vuloset nga Kryetari i Komisionit. Me lëshimin e Certifikatës së Njohjes, vijohet menjëherë me transferimin e të dhënave dhe regjistrimin e mjetit në Regjistrin “*RETRO*” .



Neni 22
Regjistri “RETRO”

Regjistri “RETRO” përmban të dhënat si më poshtë:

1. A Nr. regjistrimit (Targa)
2. B Data e regjistrimit të parë;
3. B.1 Viti i prodhimit;
4. (C.2.1) Mbiemri;
5. (C.2.2) Emri dhe NID/NUIS;
6. (C.2.3) Adresa;
7. D.1 Marka;
8. D.2 Tipi/Varianti/Versioni;
9. D.3 Emërtimi tregtar;
10. E Numri i identifikimit (nr. shasisë);
11. F.1 Masa maksimale teknike (kg);
12. F.2 Masa max. e lejuar për qarkullim (kg);
13. F.3 Masa max. e kompleksit, e lejuar (kg);
14. G Masa bosh (kg);
15. I Data e lëshimit të Certifikatës së Njohjes;
16. Afatet e vlefshmërisë së Certifikatës së Njohjes;
17. J Kategoria ndërkombëtare;
18. J.1 Destinacioni/Përdorimi;
19. J.2 Kodi i karrocërisë (BE);
20. K Numri i miratimit të tipit;
21. K.1 Numri i miratimit individual;
22. L Numri i akseve;
23. M Distanca aksiale (mm);
24. P.1 Kapaciteti (cilindrata) motorit (cm³);
25. P.2 Fuqia maksimale motorit (KW);
26. P.3 Lloji karburantit ose burimi energjisë;
27. P.4 Xhirot nominale të motorit (rrot/min);
28. P.5 Numri identifikimit motorit;
29. Q Raporti i fuqisë me peshën (kW/kg);
30. R Ngjyra (ngjyra bazë/ngjyra e dytë);
31. S.1 Numri ndenjësve, përfshi të drejtuesit;
32. S.2 Numri vendeve të qëndrimit në këmbë;
33. S Kapaciteti i vendeve (S.1+S.2);



34. T Shpejtësia maksimale (km/orë);
35. U.1 Niveli zhurmës në qëndrim [dB(a)];
36. U.2 Niveli zhurmë në regj. normal të mot. (min-1);
37. U.3 Niveli zhurmës në lëvizje [dB(a)];
38. V.1 Sasia e CO që shkarkohet (g/km);
39. V.2 Sasia e HC që shkarkohet (g/km);
40. V.3 Sasia e NOx që shkarkohet (g/km);
41. V.4 Sasia e HC+NOx që shkarkohet (g/km);
42. V.5 Sasia e grimcave që shkarkohen (g/km);
43. V.6 Koeficienti i korrigjimit të absorbimit (m-1);
44. V.7 Sasia e CO2 që shkarkohet (g/km);
45. V.8 Konsumi kombinuar i karburantit (l/100 km);
46. V.9 Treguesi i kategorisë mjedisore;
47. Kapaciteti rezervuarit lëndës djegëse (litra);
48. X Data e mbarimit të certifikatës së njohjes;
49. Numri cilindrave;
50. Numri i dyerve;
51. Gjatësia (mm);
52. Gjerësia (mm);
53. Lartësia (mm);
54. Lloji i kutisë së shpejtësisë;
55. Përmasa e gomës në aksin e pare;
56. Përmasa e gomës në aksin e dytë;
57. Përmasa e gomës në aksin e tretë;
58. Pajisur me ganxhë?;
59. Ardhur nga;
60. Statusi i mjetit;
61. Dt. çregjistrimit përhershëm;
62. Dt. çregjistrimit përkohshëm;
63. Për mjetet të cilat nuk janë të regjistruara në sistemin edpshttrr do të mbahen të dhëna sipas nenit 21, të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Targa "RETRO"

Mjeti "RETRO" pajiset me targa që plotësojnë standardet teknike, të parashikuara në Vendimin nr.153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar.

Targat "RETRO" janë dy llojesh:



1. Targë “RETRO” për Mjet;
2. Targë “RETRO” për Koleksion.

Targa “RETRO” për Koleksion është targë me karakteristika të ndryshme nga targa “RETRO”. Kjo targë mund të kërkohet vetëm nga individ, persona fizik ose juridik që disponojnë një koleksion me të paktën tre mjete në Regjistrin “RETRO”, të cilat kanë të drejtën të pajisen me një targë të vetme, e cila do të jetë e vlefshme për të gjitha mjetet, pjesë e këtij koleksioni. Targa “RETRO” për Koleksion mund të mbartet nga një mjet në tjetrin, me kushtin që mjetet t’i përkasin të njëjtit klasifikim mjeti rrugor.

Nga DPSHTRR, lëshohet një vërtetim në të cilin specifikohen numrat e identifikimit të mjeteve të cilat do të përdorin targën e koleksionit.

Neni 24

Autorizimi për lëvizje

1. Autorizimi i lëvizjes (libri i lëvizjes):
 - a. Mjetet “RETRO” mund të qarkullojnë vetëm pasi të jenë pajisur me Autorizimin për lëvizje. Autorizimi ka vlefshmëri maksimale prej 30 ditësh dhe brenda 1 viti kalendarik mund të merren deri në 3 (tre) autorizime në vit për mjetet me targë Retro.
 - b. Përjashtimisht me këtë rregull, anëtarët e shoqatave të themeluara, regjistruara dhe organizuara sipas parashikimeve të Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” i ndryshuar autorizohen të lëvizin për një afat maksimal prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh përgjatë një viti, vetëm pas nënshkrimit të një marrëveshjeje ndërmjet shoqatës, ku janë anëtarë zotëruesit e mjeteve, dhe DPSHTRR-së. Kushtet dhe modalitetet përcaktohen në marrëveshjen e miratuar.
 - c. Certifikata e Njohjes dhe Autorizimi i lëvizjes janë subjekt kontrolli nga organet ligjzbatuese dhe duhet të shoqërojnë mjetin në çdo udhëtim. Mungesa e tyre shoqërohet me masa administrative të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 25

Shërbimi në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor

1. Me paraqitjen e zotëruesit të mjetit në DRSHTRR, vijohet me procedurën e regjistrimit të mjetit dhe specialisti i regjistrimit të mjeteve kryen: verifikimin në sistemin Interpol, plotëson të dhënat në sistemin eDPSHTRR, lëshon faturën sipas tarifave përkatëse për njohjen e statusit “RETRO”.
2. Për rastin e mjeteve të regjistruara më parë, specialisti i regjistrimit kryen verifikimin për detyrime të prapambetura të mjetit, përpara regjistrimit si mjet “RETRO”.
3. Për rastet e humbjes, vjedhjes apo shkatërrimit të targës “RETRO”, zbatohet procedura e miratuar për shërbimet me mjetet rrugore (të zakonshme). Zotëruesi i mjetit “RETRO” bën aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale ku ka vendbanimin.
4. Për rastet e humbjes, vjedhjes apo dëmtimit të Certifikatës së Njohjes, veprohet në të njëjtën mënyrë si në pikën 3, të këtij neni. Specialisti i regjistrimit vijon me plotësimin e dokumentacionit dhe lëshimin e dublikatit me afatin e vlefshmërisë së mbetur.



5. Çdo shërbim tjetër dhe procedura përkatëse për një mjet “*RETRO*”, do të jetë e njëjtë me atë të mjeteve të regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve.
6. Në rastin kur mjete “*RETRO*” shitet, dhurohet, apo ndërron pronësi me ndonjë mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji, bëhet azhurnimi i Certifikatës së Njohjes, pa i'u nënshtruar sërish procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të mjetit. Certifikata lëshohet me afatin e vlefshmërisë së mbetur kundrejt tarifës përkatëse, por me emrin e pronarit të ri. Nëse pronari i ri i mjetit “*RETRO*” dëshiron të pajiset me Certifikatë me afat vlefshmërie të plotë, duhet t'i nënshtrohet procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të mjetit, sikurse çdo mjet tjetër.
7. Në rastin për ndryshimin e vendbanimit ose për ndryshimin e gjeneraliteteve, zotëruesi i mjetit “*RETRO*” duhet të përditësojë Certifikatën e Njohjes.
8. Rasti kur zotëruesi i mjetit “*RETRO*”, kërkon që të rinovojë Certifikatën e Njohjes, mjeti i nënshtrohet procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të mjetit rrugor nga komisioni “*RETRO*” si një regjistrim i ri.
9. Heqja nga qarkullimi i mjeteve “*RETRO*”, do të kryhet sipas procedurës së miratuar të shërbimeve të mjeteve rrugore për qarkullim të zakonshëm, me kërkesë të zotëruesit.

Neni 26

Shërbime dhe tarifa

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor do të ofrojë shërbimet kundrejt tarifave të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin. Shërbimet dhe tarifavat do të paraqiten të detajuara në procedurën përkatëse në zbatim të kësaj Rregulloreje.

Për rastet që nuk janë parashikuar në këtë Rregullore, aplikohen të njëjtat tarifa shërbimi sikurse për shërbimet e mjeteve rrugore të zakonshme, që janë të regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve Rrugore.



KREU VI **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 27

Të drejtat që burojnë nga zotërimi i një mjeti “RETRO”

Të gjithë subjektet që zotërojnë një mjet “RETRO”, gëzojnë të drejtat që i garanton Ligji dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje. Ndër këto, theksojmë:

1. Të drejtën për të marrë pjesë në parada, organizime, panaire, shfaqje, ture automobilistike, etj. Përfshirja në “RETRO” nuk i pengon këto subjekte të marrin pjesë në aktivitete të tjera, që nuk janë organizuar apo mbështetur nga “RETRO”;
2. Të drejtën për t’u anëtarësuar në shoqata vendase apo të huaja, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre ruajtjen, koleksionimin dhe shfaqjen e mjeteve rrugore të hershme;
3. Të drejtën të shfaqin mjetet e tyre në muze publike apo private;
4. Në rast se nuk kanë mundësi të sigurojnë ruajtjen e mjetit të tyre, kanë të drejtë të kërkojnë ruajtjen e përkohshme pranë strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Marrëveshja përkatëse do të rregullohet sipas një formati standard, të miratuar nga DPSHTRR, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe legjislacionit në tërësi.

Neni 28

Detyrimet që sjell zotërimi i një mjeti “RETRO”

Të gjithë subjektet që zotërojnë një mjet “RETRO” duhet të përmbushin detyrimet e parashikuara në Ligj dhe në dispozitat e kësaj Rregulloreje. Ndër këto theksojmë:

1. Të ruajnë dhe mirëmbajnë mjetet RETRO si dhe të përmbushin detyrimet procedurale duke siguruar akses për DPSHTRR-në në ushtrimin e kompetencave të saj ligjore;
2. Të informojnë DPSHTRR-në për çdo rast dëmtimi dhe zhvlerësimi të mjetit me qëllim rivlerësimin e tij.
3. Të njoftojë DPSHTRR-në në rastet e vjedhjes së mjetit “RETRO”, krahas dërgimit të njoftimit tek organet e tjera ligj-zbatuese;
4. Të respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor gjatë udhëtimeve me mjetin “RETRO”, si dhe të gjithë detyrimet e tjera të parashikuara në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodin Rrugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.



5. Të respektojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 29

Promovimi i trashëgimisë automobilistike

Me qëllim promovimin e historisë së motorizimit dhe nxitjen e kulturës së lidhur me mjetet historike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka të drejtë të organizojë aktivitete kulturore, shfaqje, evenimente, të blejë mjete që mbartin vlera historike, të mbrojnë trashëgiminë kulturore, si dhe të nxisë zhvillimin e këtij sektori përmes programeve formuese profesionale.

Neni 30

Detyrime të përgjithshme

Në zbatimin e kësaj Rregulloreje mbahet parasysh se:

1. Të gjitha strukturat e ngarkuara sipas kësaj Rregulloreje, duke përfshirë dhe administratën e DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-ve janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë me përpikmëri dispozitat e parashikuara më sipër;
2. Shkelja e dispozitave të kësaj Rregulloreje përbën shkak për marrjen e masave disiplinore përkatëse, sipas dispozitave ligjore të parashikuara në aktet normative në fuqi;
3. Mosnjohja e Rregullores nuk e justifikon njohësin apo zbatuesin e saj nga përgjegjësia dhe sanksionet e lartpërmendura;
4. Për kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë që nuk përfshihen në këtë Rregullore, zbatohen aktet e tjera normative që rregullojnë fushën e zbatimit të marrëdhënieve që nuk i përmban kjo Rregullore.

Zbatimi i kësaj rregulloreje do të jetë objekt kontrolli dhe auditimi.

Kjo Rregullore miratohet me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 1414/2, datë 26.02.2026 dhe hyn në fuqi menjëherë.

Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë rregullore shfuqizohet



